



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 27 shtator 2021
Nr. ref.:RK 1855/21

VENDIM PËR REFUZIM TË KËRKESËS

në

rastin nr. KI161/20

Parashtrues

Bedri Gashi

**Vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës së Apelit,
AC.nr.5487/2019, të 20 gushtit 2020**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Gresa Caka-Nimani , kryetare
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare
Safet Hoxha, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare dhe
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është dorëzuar nga Bedri Gashi, me vendbanim në fshatin Sferkë, Komuna e Klinës, me profesion avokat (në tekstin e mëtejme: parashtruesi i kërkesës).

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës kërkon vlerësimin e kushtetutshmërisë së Aktvendimit [AC.nr.5487/2019] të Gjykatës së Apelit, të 20 gushtit 2020 në ndërlidhje me Aktvendimin [CN.nr.59/2019] të 16 shtatorit 2019, të Gjykatës së Apelit (në tekstin e mëtejme: Aktvendimet e kontestuar).

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktvendimeve të kontestuar, përmes së cilave pretendohet të jenë shkelur të drejtat e parashtruesit të kërkesës të garantuara me nenin 24 [Barazia para Ligjit], nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] dhe neni 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta).

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në paragrafët 1 dhe 7, të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, nenin 22 [Procedimi i kërkesës] të Ligjit nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Ligji), si dhe në rregullin 32 [Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve] të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

5. Më 10 tetor 2020, parashtruesi i kërkesës përmes postës e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
6. Më 2 nëntor 2020, Kryetarja caktoi gjyqtaren Selvete Gërzhaliu-Krasniqi gjyqtare raportuese dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Bekim Sejdiu (kryesues), Remzije Istrefi-Peci dhe Nexhmi Rexhepi (anëtarë).
7. Më 11 nëntor 2020, Gjykata njoftoi parashtruesin e kërkesës për regjistrimin e kërkesës. Të njëjtën ditë, Gjykata i dërgoi një kopje të kërkesës Gjykatës së Apelit.
8. Më 11 maj 2021, si rezultat i një shkrese drejtuar Gjykatës, nga parashtruesit e kërkesës në lëndën KI91/20, ku po ashtu z. Bedri Gashi ka qenë përfaqësues i parashtruesve në cilësi të avokatit, Gjykata ka kuptuar që parashtruesi i kërkesës kishte ndërruar jetë pasi që ka dorëzuar kërkesën e tij në Gjykatë. Si rrjedhojë Gjykata i dërgoi një shkresë familjes Gashi me kërkesën për sqarim nëse familjarët/trashëgimtarët që kanë interes të drejtpërdrejtë dëshirojnë të vazhdojnë procedurën e shqyrtimit të kërkesës. Gjykata gjithashtu njoftoi edhe Odën e Avokatëve të Kosovës, si dhe kërkoi nga ta që të konfirmonin situatën e lartcekur.
9. Gjykata nuk ka pranuar përgjigje nga familja e parashtruesit të kërkesës, për vazhdimin e procedurës së shqyrtimit të kërkesës.

10. Në afatin e dhënë nga Gjykata, Oda e Avokatëve nuk ishte përgjigjur në kërkesën e Gjykatës.
11. Më 17 maj 2021, bazuar në paragrafin 5, të nenit 114 [Përbërja dhe Mandati i Gjykatës Kushtetuese] të Kushtetutës dhe rregullit 12 (Zgjedhja e Kryetarit dhe e Zëvendëskryetarit) të Rregullores së punës, gjyqtarja Gresa Caka-Nimani u zgjodh Kryetare e Gjykatës Kushtetuese. Bazuar në paragrafin (4) të rregullit 12 të Rregullores së punës dhe Vendimit të Gjykatës KK-SP 71-2/21, u përcaktua që gjyqtarja Gresa Caka-Nimani, detyrën e Kryetares së Gjykatës e merr pas përfundimit të mandatit të Kryetares aktuale të Gjykatës, Arta Rama-Hajrizi, më 26 qershor 2021.
12. Më 25 maj 2021, bazuar në pikën 1.1 të paragrafit 1 të nenit 9 (Përfundimi i mandatit para kohës) të Ligjit dhe rregullit 7 (Dorëheqja e gjyqtarëve) të Rregullores së punës, gjyqtari Bekim Sejdiu paraqiti dorëheqjen e tij nga pozita e gjyqtarit pranë Gjykatës Kushtetuese.
13. Më 27 maj 2021, Kryetarja e Gjykatës, Arta Rama-Hajrizi, me Vendimin nr. K.SH KI 161/20 përcaktoi që gjyqtari Bajram Ljatifi të caktohej kryesues i Kolegjit shqyrtues në vend të gjyqtarit Bekim Sejdiu, pas dorëheqjes së tij.
14. Më 26 qershor 2021, bazuar në paragrafin (4) të rregullit 12 të Rregullores së punës dhe Vendimit të Gjykatës KK-SP 71-2/21, gjyqtarja Gresa Caka-Nimani mori detyrën e Kryetares së Gjykatës, ndërsa bazuar në pikën 1.1 të paragrafit 1 të nenit 8 (Përfundimi i mandatit) të Ligjit, kryetarja Arta Rama-Hajrizi përfundoi mandatin e Kryetares dhe të gjyqtarës së Gjykatës Kushtetuese.
15. Më 2 gusht 2021, Gjykata sërish ripërsëriti kërkesën për Odën e Avokatëve të Kosovës, duke kërkuar konfirmimin nëse parashtruesi i kërkesës kishte ndërruar jetë.
16. Më 5 gusht 2021, Oda e Avokatëve të Kosovës përmes shkresës njoftoi Gjykatë se parashtruesi i kërkesës, avokati Bedri Gashi, kishte ndërruar jetë më 9 dhjetor 2020.
17. Më 10 shtator 2021, Kolegji shqyrtues e shqyrtoi raportin e gjyqtarës raportuese dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës që të refuzojë kërkesën me procedurë të shkurtër.

Përmbledhja e fakteve

18. Nga shkresat e lëndës, rezulton se parashtruesi i kërkesë në cilësinë e tij si avokat kishte përfaqësuar, klientin V.M., i cili kishte iniciuar procedurë për kthimin e tij në vendin e punës në Qendrën për Punë Sociale në Klinë. Në kuadër të përfaqësimit ligjor, parashtruesi i kërkesës dhe V.M. ishin dakorduar gojarisht se në rast se rasti përfundon me sukses, atëherë V.M. obligohej që parashtruesin e kërkesës ta kompensonte me shumën e përcaktuar në bazë të nenit 5 të Tarifës së Odës së Avokatëve të Kosovës.

19. Më 12 mars 2012, si rezultat i mospërmbushjes së pagesës së kompensimit siç pretendohet nga parashtruesi i kërkesës, ky i fundit kishte paraqitur padi në Gjykatën Themelore në Pejë, përmes së cilës kishte kërkuar që V.M. t'ia paguante atij kompensimin për shpërblimin e punës së tij dhe suksesin e arritur në procedurën e kthimit të klientit të tij në vendin e punës.
20. Më 3 prill 2015, V.M. përmes përgjigjes në padi kishte kundërshtuar në tërësi padinë si të pabazuar, duke theksuar se e kishte kompensuar parashtruesin e kërkesës sipas marrëveshjes gojore, për punët që kishte kryer dhe për më tepër kishte theksuar se parashtruesi i kërkesës nuk ka qenë asnjëherë përfaqësues i tij me autorizim si dhe nuk e kishte përfaqësuar para asnjë institucioni.
21. Më 18 prill 2016, Gjykata Themelore në Pejë, Dega në Klinë (në tekstin e mëtejshëm: Gjykata Themelore) përmes Aktgjykimit [C.nr.67/13] kishte refuzuar kërkesëpadinë e parashtruesit të kërkesës si të pabazuar duke theksuar se *"Përfundimisht nga provat e parashtruara nga pala paditëse ndërgjyqësit kësaj gjykate në shkresat e lëndës tashmë të administruara, por edhe mbi bazën e parashtrimeve të deklaruara drejtpërdrejt nëpërmjet procesverbaleve në të gjitha seancat e mbajtura të shqyrtimeve gjyqësore për më shumë në fjalën përfundimtare të paditësit si dhe deklarimin e të të autorizuarit të të paditurit, Gjykata e çështjes kontestimore sikur në rastin konkret gjeti se në mes të palëve ndërgjyqësve nuk ka ekzistuar marrëdhënie kontraktuale detyrimore sikur në rastin konkret, përkatësisht se marrëdhënia detyrimore kontraktuese është rrjedhojë e ekzistimit të kontratës për punët e kryera dhe mbi bazën e se njëjtës ka ardhur se pala paditëse nuk ka prova të tilla që e dëshmojnë një gjë të tillë, andaj Gjykata ka ardhur në përfundim se padinë dhe kërkesëpadinë e paditësit duhet refuzuar si të pabazë dhe të pa argumentuar pasi që këtë gjë edhe pala e paditur e ka kundërshtuar dhe i ka propozuar gjykatës që padinë ta refuzoj si të pabazuar, e në bazë të provave dhe deklarimeve të palëve ndërgjyqësve Gjykata nuk gjeti asnjë bazë për të vërtetuar bazën juridike të kërkesëpadisë dhe nga kjo vendosi që të refuzoj të njëjtën".*
22. Më 5 dhjetor 2016, parashtruesi i kërkesës parashtroi ankesë në Gjykatën e Apelit kundër Aktgjykimit të lartpërmendur të Gjykatës Themelore, duke pretenduar shkelje esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetim të gabuar të gjendjes faktike dhe zbatim të gabuar të së drejtës materiale.
23. Më 6 mars 2019, Gjykata e Apelit përmes Aktgjykimit [Ac.nr.3299/16] refuzoi si të pathemeltë ankesën e parashtruesit të kërkesës, duke konstatuar se Aktgjykimi i Gjykatës Themelore është i drejtë dhe i ligjshëm, nuk është i përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, dhe se drejtë është aplikuar e drejta materiale. Gjykata e Apelit, për më tepër kishte shtuar se parashtruesi i kërkesës nuk kishte ofruar prova se i njëjti kishte pasur ndonjë kontratë me shkrim, të lidhur me V.M.
24. Më 17 prill 2019, parashtruesi i kërkesës kishte parashtruar propozim për përsëritje të procedurës në Gjykatën e Apelit, kundër Aktgjykimit të lartpërmendur të Gjykatës së Apelit duke pretenduar shkelje të dispozitave të procedurës kontestimore, me propozimin që të lejohet përsëritja e procedurës.

25. Më 16 shtator 2019, Gjykata e Apelit, përmes Aktvendimit [CN.nr.59/2019], refuzoi si të pabazuar propozim për përsëritje të procedurës, duke theksuar se nuk janë plotësuar kushtet e kërkuara me Ligjin për Procedurën Kontestimore, që lejojnë përsëritjen e procedurës.
26. Më 21 tetor 2019, parashtruesi i kërkesë parashtroi ankesë në Gjykatën e Apelit kundër Aktvendimit të lartpërmendur të Gjykatës së Apelit.
27. Më 20 gusht 2020, Gjykata e Apelit, përmes Aktvendimit [AC.nr.5487/2019] refuzoi si të pabazuar ankesën e parashtruesit të kërkesës dhe vërtetoi Aktvendimin [CN.nr.59/2019] të 16 shtatorit 2019, të Gjykatës së Apelit.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

28. Gjykata rikujton se parashtruesi i kërkesës pretendon se përmes Aktvendimeve të kontestuara i janë shkelur të drejtat e tij të garantuara me nenin 24 [Barazia para Ligjit] nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] dhe nenin 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] të Kushtetutës.
29. Parashtruesi i kërkesës pretendon se ai e kishte përfaqësuar V.M. në procedurën për kthimin e tij në vendin e tij të mëparshëm të punës, por më pas V.M. nuk e kishte kompensuar parashtruesin e kërkesës për punën e kryer në bazë të marrëveshjes së tyre gojore.
30. Specifikisht, parashtruesi i kërkesës para Gjykatës thekson *“Pra, meqë për autorizim nuk ka patur nevojë, ndërsa nëse nuk kam patur marrëveshje, apo kontrate me shkrim me të paditurin si klient, për mënyrën e pagesës, konsideroj se vlen dispozita nga neni 58 i Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve Nr. 04/L-007 i Kosovës i vitit 2012. [...] Nga ky interpretim, e kuptoj se unë si palë paditëse-si avokat, ndaj te paditurit-si klient, i kam krye obligimet e punës s'ime shkresore dhe e kam arritur suksesin që i padituri të kthehet në punë, por ai me përkrahjen e gjykatave, nga shk. I-rë e gjerë tek ato të shk. II-të, e mbështetin kështu pandershmërinë e palës së paditur që u iki obligimeve, ndërsa i shkelur te drejtat e mia kushtetuese, ligjore dhe nga Tarifa e OAK-se”.*
31. Në fund, parashtruesi i kërkesës kërkon nga Gjykata që të konstatohet se *“a është vepruar drejtë apo jo, ka shkelje të dispozitave materiale dhe procedurale lidhur me të drejta ligjore të punës së drejtë të paditësit si avokat”.*

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

32. Gjykata së pari vlerëson nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuar më tej me Ligj dhe me Rregullore të punës.
33. Në këtë drejtim, Gjykata, fillimisht, i referohet paragrafëve 1 dhe 7, të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, që përcaktojnë:

“1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.

[...]

7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.”

34. Gjykata, më tej, i referohet nenit 47 [Kërkesa individuale], nenit 48 [Saktësimi i kërkesës] dhe nenit 49 [Afatet] të Ligjit të cilët përcaktojnë:

Neni 47
[Kërkesa individuale]

1. Çdo individ ka të drejtë të kërkojë nga Gjykata Kushtetuese mbrojtje juridike në rast se pretendon se të drejtat dhe liritë e tija individuale të garantuara me Kushtetutë janë shkelur nga ndonjë autoritet publik.

2. Individ i mund ta ngritë kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.

Neni 48
[Saktësimi i kërkesës]

“Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësojë saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj.”

Neni 49
[Afatet]

“Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajve. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor...”

35. Për sa i përket përmbushjes së këtyre kriterëve, Gjykata konstaton se në momentin e parashtrimi të kërkesës parashtruesi i kërkesës kishte qenë palë e autorizuar; e kontestoi një akt të një autoriteti publik, përkatësisht Aktvendimin [AC.nr.5487/2019] të 20 gushtit 2020, të Gjykatës së Apelit, në ndërlidhje me Aktvendimin [CN.nr.59/2019] të 16 shtatorit 2019, të Gjykatës së Apelit, dhe se kërkesën e kishte paraqitur pas shterimit të të gjitha mjeteve juridike.
36. Gjykata si rezultat i informatës se parashtruesi i kërkesës kishte ndërruar jetë pasi që kishte dorëzuar kërkesën e tij në Gjykatë, kërkoi nga Oda e Avokatëve të Kosovës të konfirmoj ndryshimin e rrethanave për parashtruesin e kërkesës.
37. Gjykata, më 5 gusht 2021, pranoi përgjigjen nga Oda e Avokatëve të Kosovës se parashtruesi i kërkesës kishte ndërruar jetë.

38. Më tutje, Gjykata i dërgoi një shkresë familjes së parashtruesit të kërkesës me përmbajtjen si në vijim: *“Gjykata me qëllim të vazhdimit të procedurës së shqyrtimit të kërkesës, të parashtruar nga z. Gashi luteni që të konfirmoni nëse familjarët/trashëgimtarët që kanë interes të drejtpërdrejtë dëshirojnë të vazhdojnë procedurën e shqyrtimit të kërkesës”.*
39. Gjykata nuk ka pranuar përgjigje nga familja e parashtruesit të kërkesës, për vazhdimin e procedurës së shqyrtimit të kërkesës.
40. Në ndërlidhje me rrethanat e reja të paraqitura në rastin para nesh, Gjykata po ashtu i referohet rregullit 35 [Kriteret e pranueshmërisë] të Rregullores së punës. Specifikisht, rregulli 35 (4) përcakton që:

Rregulli 35
(Tërheqja, hedhja poshtë dhe refuzimi i kërkesës)

[...]

(4) Gjykata mund ta hedhë poshtë një kërkesë, kur Gjykata përcakton se pretendimi nuk është në mënyrë aktive i diskutueshëm, nuk paraqet një çështje të drejtë gjyqësore dhe nuk ka çështje të veçanta të të drejtave të njeriut të pranishme në rast.

41. Gjykata thekson se rregulli i lartcekur i Rregullores së punës, i mundëson Gjykatës që të refuzojë një kërkesë me procedurë të shkurtër nëse, ndër të tjera, pretendimi nuk është në mënyrë aktive i diskutueshëm, nuk paraqet një çështje të drejtë gjyqësore dhe nuk ka çështje të veçanta të të drejtave të njeriut të pranishme në rast.
42. Gjykata rikujton se esenca e rastit dhe që ka të bëjë me një kontratë gojore të dakorduar ndërmjet parashtruesit të kërkesës dhe klientit të tij V.M., ku parashtruesi i kërkesës në cilësi të avokatit kishte përpiluar shkresa në institucionet relevante në funksion të përfaqësimit të klientit të tij për kthimin e këtij të fundit në vendin e punës në Qendrën për Punë Sociale në Klinë. Sipas parashtruesit të kërkesës me V.M. ishin dakorduar gojarisht se në rast se rasti përfundon me sukses, atëherë në bazë të nenit 5 të Tarifës së Odës së Avokatëve të Kosovës, V.M. obligohej ta kompensojë parashtruesin e kërkesës për punën e kryer. Parashtruesi i kërkesës kishte paraqitur kërkesëpadi në Gjykatën Themelore në Pejë, për kompensimin dhe shpërblimin e punës nga V.M., për suksesin e arritur në procedurën e kthimit të tij në vendin e punës. Gjykata Themelore kishte refuzuar padinë e parashtruesit të kërkesës si të pabazuar me arsyetimin se pretendimet e tij ishin të pambështetura dhe se parashtruesi i kërkesës nuk kishte ofruar prova në mbështetje të pretendimeve të tij. Pas ankesës së parashtruesit të kërkesës në Gjykatën e Apelit, kjo e fundit kishte refuzuar ankesën si të pabazuar. Parashtruesi i kërkesës kishte paraqitur kërkesë për përsëritjen e procedurës në Gjykatën e Apelit, dhe kjo e fundit refuzoi si të pabazuar propozimin për përsëritje të procedurës. Pas ankesës së parashtruesit të kërkesës kundër Aktvendimit të Gjykatës së Apelit, Gjykata e Apelit përfundimisht përmes Aktvendimit të saj [AC.nr.5487/2019] të 20 gushtit 2020 refuzoi ankesën e tij si të pabazuar. Gjykata rikujton se parashtruesi i kërkesës

pretendon se me Aktvendimet e kontestuarra i janë shkelur të drejtat e mbrojtura me nenin 24 [Barazia para Ligjit] nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] dhe nenin 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] të Kushtetutës.

43. Gjykata rikujton se parashtruesi i kërkesës më 10 tetor 2020 kishte dorëzuar kërkesën e tij në Gjykatë. Në vijim, Gjykata po ashtu rikujton se si rezultat i njoftimit se parashtruesi i kërkesës kishte ndërruar jetë, si dhe për pasojë se parashtruesi i kërkesës nuk ishte përfaqësuar me përfaqësues ligjor në procedurë para Gjykatës, më 11 maj 2021, Gjykata i dërgoi një shkresë familjes Gashi me kërkesën për të sqaruara nëse familjarët/trashëgimtarët që kanë interes të drejtpërdrejtë dëshirojnë të vazhdojnë procedurën e shqyrtimit të kërkesës.
44. Në afatin e dhënë nga Gjykata, askush nga familjarët/trashëgimtarët e parashtruesit të kërkesës, nuk është përgjigjur në shkresën e Gjykatës të datës 11 maj 2021, dhe rrjedhimisht nuk kanë sqaruar para Gjykatës nëse familjarët/trashëgimtarët që kanë interes të drejtpërdrejtë dëshirojnë të vazhdojnë procedurën e shqyrtimit të kërkesës.
45. Bazuar në konfirmimin e pranuar më 5 gusht 2021, nga Oda e Avokatëve të Kosovës se parashtruesi i kërkesës ka ndërruar jetë pas dorëzimit të kërkesës në Gjykatë, dhe në mungesë të sqarimit nga ana e familjarëve/trashëgimtarëve që kanë interes të drejtpërdrejtë nëse dëshirojnë të vazhdojnë procedurën e shqyrtimit të kërkesës, në rrethana konkrete, Gjykata përcakton se pretendimi nuk është në mënyrë aktive i diskutueshëm, gjegjësisht Gjykata nuk ka rast para vetes.
46. Gjykata konstaton se kërkesa e parashtruesit të kërkesës, nuk i përmbush kriteret procedurale për shqyrtim të mëtejshëm, për shkak se pretendimi nuk është në mënyrë aktive i diskutueshëm, siç është përcaktuar në paragrafin (4) të rregullit 35 të Rregullores së punës.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, nenin 20 të Ligjit dhe rregullin 35 (4) të Rregullores së punës, më 10 shtator 2021, njëzëri

VENDOS

- I. TË REFUZOJË kërkesën;
- II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;
- III. TË PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;
- IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtarja raportuese

Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese

Selvete Gërxhaliu-Krasniqi

Gresa Caka-Nimani

